



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti  
Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor  
Nr : 04-353/01-12867  
Data: 04.11.2024  
P r i z r e n

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

**DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSIROR KK – PRIZREN,** me kërkesën e **Rrahman, Ergin, Refret dhe Nadir Shantir** nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar leje për **„Vendosjen e Paneleve Solare fotovoltaike 22kWp në objekt ndertesës afariste”** vendosja do të bëhet në kulmin e objektit për afarizem, në bazë të nenit 3 paragrafit 1, pika 1.27 të Ligjit për Planifikim Hapësinor me Numër 04/L-174 të datës 31. 07. 2013, neni 3 paragrafi 1 pika 1.1, 1.4, 1.17, 1.24, si dhe neni 5, paragrafit 1.1 e lidhur me nenin 14 paragrafi 1 pika 1.1 neni 15 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për Ndërtim numër 04/L-110, dhe sipas Vendimit për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit (HZK) për periudhën 2022 – 2030 – Numër 001-011-48192 të datës 31. 03. 2022 si dhe konform neni 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 44, 46, 47, 48 si dhe neni 125 të L.P.P.A numër 05/031 të datës 25. 05. 2016 merr këtë:

## A K T V E N D I M

**I LEJOHET: Rrahman, Ergin, Refret dhe Nadir Shantir** nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar leje për **„Vendosjen e Paneleve Solare fotovoltaike 100kWp në objekt-ndertesës- afariste”** vendosja do të bëhet në kulmin e objektit e cila gjendet në kuadër të ngastrës katastrale **P -71813023-00149-2** me sip **5000m<sup>2</sup>**, **O-71813063-23-0** me sip.**1344m<sup>2</sup>** **Z.K. Petrovë.**

- I.** Dokumentacioni teknik-Projekti (projektuesi) „Cn Solars L.L.C.” me seli në Prizren
- II.** Datën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspektionin komunal në afat prej 8 ditësh.
- III.** Vendosja e rrjetit të bëhet sipas dokumentacioni teknik..
  - Investitori është i obliguar që punimet të kryen në bazë të dokumentacioni teknik-projektë e në pajtim me normat ndërtimore dhe rregullave të përkohshme teknike për kësi llojë punime:
  - Sipas pëlqimit elektroenergjetik : nr.10299, të dt.29.07.2024
  - Sipas vendimit DSHP –Leja Mjedisore Komunale me nr.05-352-133971 te dt.18.10.2024
- IV.** Investitori është i obliguar që punimet rreth infrastruktures termike të kryen sipas Aktvendimit të dhëna, kurse vend punimi natën të ndriqohet me dritë, kurse materialet të tjera duhet të menjanohen nga rruga ku janë kryer punimet.
- V.** Ky aktvendim pushon të vlejë në rastë se me punë nuk fillohet mbrenda afatit prej 12(dymbdhjetë) muajsh,duke llogaritur nga dita e marjes së të njëjtës

VI. Pas kryerjes së punimeve Investitori është i obliguar që vendin menjëherë të bjerë në gjendje të mëparshme dhe cdo demtim obligimi mbetet I investitorrit.

VII. Në qoftëse punimet në infrastrukture nuk mund të kryen në afatin e lejuar, Investitori është i obliguar që të kërkoj nga ky organ leje për vazhdimin e afatit të punimeve.

VIII. Ky aktvendim pushon të vlejë në rastë se me punë nuk fillohet mbrenda afatit prej 12 (dymbdhjetë) muajsh, duke llogaritur nga dita e marrjes së të njëjtës

## A r s y e t i m

**Rrahman, Ergin, Refret dhe Nadir Shantir** nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar leje për **„Vendosjen e Paneleve Solare fotovoltaike 22kWp në objekt ndertesës afariste”** vendosja do të bëhet në kulmin e objektit e cila gjendet në kuadër të ngastrës katastrale P -71813023-00149-2 me sip. 5000m<sup>2</sup>, O-71813063-23-0 me sip.1018.37m<sup>2</sup> Z.K. Petrovë.

Duke shqyrtuar kërkesën e Investitorit si dhe dokumentacionit teknik dhe të shtojcave tjera të prezentuara s'bashku me kërkesë vërtetohet se:

Në procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional.

Në kuptim të dispozitave të lartë theksuara është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes për: **„Vendosjen e Paneleve Solare fotovoltaike 22kWp në objekt-ndertesës-afariste”**Nga se u tha më lartë uvendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor-Prishtinë.

Ankesa taksohet me 0,50 Euro taksa administrative.

**Bashkëpunëtor profesional:**

  
Shpresa Osmanollaj Krapa, inxh. dip. ark.

**DREJTORI:**

  
Pranverim Berisha, jur. dip.